

Data _____

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtjen e sistemit MAXIMO”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT 48614000-5 – Infrastruktura e rrjetit.

VLERA E FONDIT LIMIT: 39,717,000 (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

33, te ligjit 10091 date 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **39,717,000.00 (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë)** leke pa TVSH.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021,2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete në masën **39,717,000.00 (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë)** leke pa TVSH.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15,886,800 (pesëmbëdhjete milion e teteqind e tetëdhjete e gjashtë mijë e teteqind) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje produktesh/shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të produkteve/shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontratë të ngjashme, të jetë rreth 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:

- a) **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);

b) **ISO 27001:2022** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);

c) **ISO/IEC 20000-1:2018** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit (e vlefshme);

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nisur nga proceset e punës dhe rendesise se sistemit software dha pajisjeve hardware, në objekt të ketij shërbimi mirembajtje, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij dhate përgatitjes së infrastruktures së re hardware dhe përditesimit të versioneve të sistemit operativ dhe databazës, të bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë e kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Sistemi i menaxhimit të siguron se informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përqasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

2. Operatori Ekonomik duhet të jetë i Autorizuar nga Prodhuesi/distributori i autorizuar (ku të provohet lidhja e prodhuesit me distributorin), për shitjen e suportit për sistemin, server dhe storage egzistues referuar specifikimeve teknike. Ky kriter të provohet nepermjet dokumentacionit të leshuar nga prodhuesi/distributori i autorizuar në emër të Operatorit Ekonomik për territorin e Shqipërisë.

Argumentimi: Operatorët ekonomikë lidhen me prodhuesit ndërkombëtarë/Distributorët e autorizuar të tyre, me qëllim uljen e kostove, marrjen e trajnimeve përkatëse për punonjësit edhe

gjatë zbatimit të kontratës, marrjen e suportit në nivel prodhuesi në kohë reale, ndaj është domosdoshmerisht dorezimi i këtij Autorizimi, ne dobi të perdoruesve finale dhe produkteve me cilesore, origjinale dhe me zbatim me rigoroz të garancise, duke siguruar vijueshmeri ne funksionalitetin e mevonshem sidomos ne periudhen Post-Garanci. Ne kete menyre provohet dhe aftesia reale e Operatorit Ekonomik per te realizuar kontraten ne cilesi (prove e origjinalitetit te produkteve) sasi e kohe dhe rrjedhimisht ne vijim per te zbatuar kushtet e garancisë.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses te kontratës, duhet te kete te punesuar per muajin e Nentor 2023, jo me pak se 9 punonjes dhe të disponojë si staf te tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- a. Të pakten 1 (një) punonjës të çertifikuar në menaxhimin e ofrimit te sherbimeve ITIL ose ekuivalente.*

Argumentim: Per shkak te rendesise se larte qe ka sistemi ne objekt te kesaj kontrate, eshte e domosdoshme qe menaxhimi i kesaj kontrate te kryhet nga nje personel i certifikuar ne fushen e menaxhimit te sherbimeve IT.

- b. Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar per analize sistemesh ose ekuivalente.*

Argumentim: Per te siguruar saktesine e nevojshme ne analizimin e kerkesave eventuale gjate kohezgjatjes se kontrates, nevojitet te pakten dy punonjes qe te kete njohurite e duhura dhe te deshmuara ne procesin e analizimit te kerkesave te sistemeve.

- c. Te pakten 1 (një) punonjës të çertifikuar si testues software ose ekuivalente.*

Argumentim: Per te siguruar qe cdo ndryshim, pershtatje, modifikim, shtim funksionaliteti eshte ne parametrat e duhur teknike dhe funksionale, duhet qe paraprakisht te testohet ne menyre te sakte nga nje punonjes qe zoteron teknikat e testimit software, deshmuar kjo me ane te certifikimit te kerkuar.

- d. Të pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per databaza relacionale ose ekuivalente.*

Argumentim: Per te siguruar cilesi te larte gjate ne realizimin e sherbimeve qe do te kerkohen gjate zbatimit te kontrates nevojiten te pakten 1 punonjes qe te kene njohurite e duhura ne menaxhimin e databazave.

- e. Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per ciklin e zhvillimit software ose ekuivalente.*

Argumentim: Per te siguruar qe ne kuader te mirembajtjes, ndryshimet, pershtatjet dhe modifikimet e nevojshme ne sistemi, do te kryhen me pergjegjesi profesionale dhe me

cilesi, eshte e domosdoshme qe Operatori Ekonomik te kete ne stafin e vet te pakte 2 punonjes me njohuri te certifikuara per ciklin e zhvillimit software.

- f. Të pakten 1 (nje) punonjes të certifikuar per administrimin e sistemeve operativ ose ekuivalente.*

Argumentim: Per te siguruar qe monitorimi dhe korrigjimet e nevojshme te problematikave qe mund te kene sistemet operative te serverave, eshte vleresuar e domosdoshme qe Operatori Ekonomik te vere ne dispozicion te kontrates te pakten nje punonjes me njohuri te konfirmuara nepermjet certifikimit ne fushen e administrimit te sistemeve operative.

- g. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per platformen e virtualizimit ku mbeshtetet platforma per menaxhimin operacional-teknik të aseteve të rrjetit ose ekuivalente.*

Argumentim: Per nga vete rendesia e sistemit object kontrate lind e nevojshme qe operatori ekonomik te kete minimumi 1 (nje) punonjes te certifikuar per te garantuar Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës ne kuader te mirembatjes te platformes se virtualizimit.

- h. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per pajisjet server dhe storage ku eshte implementuar platforma per menaxhimin operacional-teknik të aseteve të rrjetit ose ekuivalente.*

Argumentim: Per te siguruar qe pajisjet server dhe storage ne objekt te kontrates, mirembahen nga punonjes te specializuar ne kete fushe, AK ka pare te nevojshme qe Operatori Ekonomik te vere ne dispozicion te kontrates te pakten nje punonjes me njohuri te konfirmuara nepermjet certifikimit te kerkuar.

Një specialist mund te ketë 1 (një) ose me shume certifikime për te përmbushur kërkesat e mësipërme.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperem si pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten si ne vijim edhe:

- 1) Certifikatat perkatese te kualifikimit;*
- 2) Listepagesa e punonjesve per muajin Nentor 2023 dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente ;*
- 3) Vërtetim nga tatimet, që ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore për muajin e Nentor 2023, ku të pasqyrohet numri i punonjësve;*
- 4) Kontratën/at e punes konform legjislacionit ne fuqi të lidhura me stafin e nevojshëm.*

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termat e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

